FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 248

Tiranë – E mërkurë, 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 799, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Aishe Daut Stari	31315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 800, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Vasillaq Thoma Ruci	31315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Shegushe Hysni Bebeti	31315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 802, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Nikolin Luigj Gurakuqi	31315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Agustin Pjetër Kola	31316
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Kostandin Aleko Kamberi	31316
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror znj. Edera Kabil Alibegaj	31316
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Leonard Sifi Toska	31317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Rapo Selman Tao	31317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Kujtim Rexhep Vorpsi	31317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Kostandin Llazar Shkurti	31318

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Virxhil Athanas Karaja.....	31318
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Agim Nuri Bajko	31318
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 30.12.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre", të ndryshuar.....	31318
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 30.12.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë"	31319
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 30.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 493, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese", të ndryshuar	31320
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 30.12.2025	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkinë Shijak.....	31320
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 819, datë 30.12.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 428, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", të ndryshuar.....	31321
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 820, datë 30.12.2025	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës së mesme të bashkuar "Ramazan Karaj", Bashkia Krujë, dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese.....	31322
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 30.12.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 684, datë 6.11.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë aksionare 'Enti Kombëtar i Operimit Rrugor' sh.a."	31322
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 30.12.2025	Për përcaktimin e rasteve, kushteve dhe procedurave të marrjes së vendimit për përfshirjen e subjektit në Regjistrin e Posaçëm të Subjekteve të Përjashtuara nga veprimtaritë prodhuese të armëve dhe të teknologjive ushtarake.....	31323
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 30.12.2025	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe shoqërisë "*Adriatic Bay Investment Group*" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 1/10, me emërtimin "Reparti ushtarak 2001 – ish-Depo e Minave Durrës", zona kadastrale 1574, me sipërfaqe të përgjithshme 52 010 m^2, me vendndodhje në Porto-Romano, Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes	31326

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 30.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 355, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e pronës shtetërore në zonën kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik 'Ngritja e plantacionit me shegë, *goji berry*, kivi, rrush, dardhë etj., si dhe zhvillimin e agroturizmit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë"', të ndryshuar.....	31335
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 30.12.2025	Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve.....	31335
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 829, datë 30.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre", të ndryshuar.....	31338
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 830, datë 30.12.2025	Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për financimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar me impakt social, kulturor, ekonomik dhe turistik në vend, në rastet kur zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.....	31340
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 30.12.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025", të ndryshuar.....	31341
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 30.12.2025	Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, për vitin 2025.....	31343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 836, datë 30.12.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", të ndryshuar.....	31343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 30.12.2025	Për miratimin e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira në fushën e pyjeve.....	31343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 842, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Todi Ndoni Llupi	31384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 843, datë 30.12.2025	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Sulejman Petrit Dorova Starova.....	31384
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 30.12.2025	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 17.7.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e modelit dhe përcaktimin e rregullave të mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit, si dhe të procedurave të regjistrimit të kontratës së sipërmarrjes, porosisë dhe të premtimshitjes"	31384

VENDIM
Nr. 799, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. AISHE DAUT STARI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Aishe Daut Stari, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 800, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. VASILLAQ THOMA RUCI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Vasillaq Thoma Ruci, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 801, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. SHEGUSHE HYSNI BEBETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Shegushe Hysni Bebeti, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 802, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. NIKOLIN LUIGJ GURAKUQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Nikolin Luigj Gurakuqi, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 803, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. AGUSTIN PJETËR KOLA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Agustin Pjetër Kola, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 804, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. KOSTANDIN ALEKO KAMBERI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Kostandin Aleko Kamberi, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 805, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. EDERA KABIL ALIBEGAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Edera Kabil Alibegaj, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta,

plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 806, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. LEONARD SIFI TOSKA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Leonard Sifi Toska, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 807, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. RAPO SELMAN TAO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Rapo Selman Tao, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 808, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. KUJTIM REXHEP VORPSI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Kujtim Rexhep Vorpsi, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 809, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. KOSTANDIN LLAZAR SHKURTI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Kostandin Llazar Shkurti, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 810, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. VIRXHIL ATHANAS KARAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Virxhil Athanas Karaja, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 811, datë 30.12.2025

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. AGIM NURI BAJKO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Agim Nuri Bajko, në masën e dhjetëfishit të pensionit social, por shuma e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, dhe përfitimeve të caktuara sipas ligjeve për skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta, plus këtë shtesë, të mos kalojë dymbëdhjetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 815, datë 30.12.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E RIMORKIOVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për

transportet rrugore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 7, të vendimit nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data "... 31 dhjetor 2025." zëvendësohet me "... 31 dhjetor 2026.".

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 816, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 837, DATË 26.12.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, KAMZË, MIRDITË, SHIJAK, KRUJË DHE VORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë", bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2025, nga bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë, në masën 501 942 235 (pesëqind e një milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 136 643 876 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 46 682 144 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 177 818 041 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 140 798 174 (njëqind e dyzet milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Efekti financiar, për vitin 2025, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet bashkive Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 817, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 493, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAVAJË DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 493, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë dhe caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2025, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 161 122 007,65 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e njëqind e njëzet e dy mijë e shtatë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i kopshtit/çerdhes në fshatin Luz i Vogël, Bashkia Kavajë, në masën 34 658 401 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e një) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i kopshtit/çerdhes në fshatin Golem, Bashkia Kavajë, në masën 126 463 606,65 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.".

b) Në pikën 3, togfjalëshi "... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ..." zëvendësohet me "... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 818, datë 30.12.2025

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKINË SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 37 228 725 (tridhjetë e shtatë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, në Bashkinë Shijak.

2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, të cilat i transferohen Bashkisë Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 819, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 428, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE TË MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË TYRE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT DHE UJIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 46/1, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun I, të vendimit nr. 428, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas shkronjës "f", të pikës 3, shtohet shkronja "g", me këtë përmbajtje:

"g) certifikata për përfundimin e punimeve të karabinasë.".

2. Në pikën 4 bëhen këto shtesa:

a) Në fillim të shkronjës "a" shtohen fjalët "... për kërkesat për leje zhvillimi, ...";

b) Në fillim të shkronjës "b" shtohen fjalët "... për kërkesat për leje zhvillimi, ...";

c) Pas shkronjës "b", të pikës 4, shtohen shkronjat "c" dhe "ç", me këtë përmbajtje:

"c) për kërkesat për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit, kur ndryshimi apo rishikimi i lejes së zhvillimit kryhet brenda kufirit të miratuar me një leje zhvillimi dhe nuk shoqërohet me shtim të sipërfaqes së përgjithshme të pronës apo kur kërkesa për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit shoqërohet me zvogëlim të sipërfaqes së miratuar me një leje zhvillimi, tarifa është fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë;

ç) për kërkesat për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit, kur ndryshimi apo rishikimi i lejes së zhvillimit shoqërohet me shtim të sipërfaqes së përgjithshme të pronës, tarifa llogaritet si total i tarifës fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, dhe shtohet vlera prej 100 (njëqind) lekë për m^2, vetëm për sipërfaqen shtesë.".

3. Pas fjalisë së parë të pikës 8/1 shtohen fjalitë, me këtë përmbajtje:

"Në rast se ndërmjet situacionit përfundimtar të punimeve dhe preventivit fillestar të investimit të deklaruar nuk ka diferencë apo vlera e situacionit përfundimtar është më e vogël sesa vlera e preventivit fillestar ose në rastet e certifikatave të veçanta, sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 42, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, tarifa është fikse, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e certifikatave për përfundimin e punimeve të karabinasë është fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë.".

II. Dispozitë kalimtare

Agjencia e Zhvillimit të Territorit merr të gjitha masat për lëshimin e faturave, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim, për të gjitha vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, që nënshkruhen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

III. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 820, datë 30.12.2025

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR "RAMAZAN KARAJ", BASHKIA KRUJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUJË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", dhe 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 315 401 450,36 (treqind e pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e një mijë e katërqind e pesëdhjetë presje tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës së mesme të bashkuar "Ramazan Karaj", Bashkia Krujë.

2. Bashkisë Krujë, në buxhetin e vitit 2025, i transferohet fondi në masën 63 080 290 (gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025.

3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 821, datë 30.12.2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 684, DATË 6.11.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE 'ENTI KOMBËTAR I OPERIMIT RRUGOR' SHA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14, të vendimit nr. 684, datë 6.11.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë aksionare 'Enti Kombëtar i Operimit Rrugor' sh.a.", shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

"14/1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në programin "Transporti rrugor", i shtohet fondi në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për rritje të kapitalit të EKORR sh.a.-së, për mbulimin e veprimtarisë operacionale, i cili përballohet nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2025.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 824, datë 30.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE, KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE TË MARRJES SË VENDIMIT PËR PËRFSHIRJEN E SUBJEKTIT NË REGJISTRIN E POSAÇËM TË SUBJEKTEVE TË PËRJASHTUARA NGA VEPRIMTARITË PRODHUESE TË ARMËVE DHE TË TEKNOLOGJIVE USHTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 34, të ligjit nr. 87/2024, "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka për objekt:

a) përcaktimin e rasteve dhe kushteve për përfshirjen në Regjistrin e Posaçëm të Subjekteve të Përjashtuara (në vijim "Regjistri") të individëve apo të subjekteve juridike, që kanë shkelur dispozitat ligjore dhe nënligjore në fushën e industrisë së mbrojtjes, që përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare ose që janë të sanksionuara nga organizatat ndërkombëtare për transaksione financiare apo operacione tregtare, në kundërshtim me legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar;

b) përcaktimin e procedurave administrative për përfshirjen dhe heqjen e subjekteve nga Regjistri, duke garantuar një proces të drejtë, të qartë e të hapur në çdo fazë të tij;

c) ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes (në vijim AIM) për qëllime institucionale të administratës publike, me synim pasqyrimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të listës së individëve e të subjekteve juridike të përjashtuara.

Neni 2
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të garantojë sigurinë kombëtare dhe përputhshmërinë me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të një mekanizmi transparent dhe efektiv për identifikimin, përfshirjen e publikimin e individëve e të subjekteve, që përfshihen në Regjistrin e Posaçëm të Subjekteve të Përjashtuara.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Subjekt i përjashtuar",** çdo individ ose subjekt, i licencuar, në fazë licencimi ose edhe pa licencë në Republikën e Shqipërisë, i cili ka shkelur dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi për industrinë e mbrojtjes, që përbën kërcënim për sigurinë kombëtare ose është i sanksionuar nga organizatat ndërkombëtare për kryerjen e transaksioneve financiare e të operacioneve tregtare, në kundërshtim me legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar, për të cilin është marrë vendimi për përjashtim.

2. "Shkelje ligjore", çdo veprim apo mosveprim i kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake e çdo akt tjetër ligjor të aplikueshëm në fushën e industrisë së mbrojtjes.

3. "Kërcënim për sigurinë kombëtare", çdo rast që i referohet veprimeve ose lidhjeve të subjekteve të përjashtuara, që mund të rrezikojnë ose cenojnë sigurinë kombëtare e ndërkombëtare përmes veprimtarive të tyre, përfshirë këtu edhe aktivitete në fushën e terrorizmit ose krimit të organizuar.

II. KUSHTET DHE RASTET E PËRFSHIRJES

Neni 4
Rastet dhe kushtet e përfshirjes në Regjistër

1. Në Regjistër përfshihen subjektet e licencuara, subjektet në proces licencimi, si dhe çdo subjekt fizik apo juridik që operon në sektorin e mbrojtjes,

kur plotësojnë një ose më shumë nga rastet e mëposhtme:

a) Cenojnë sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;

b) Veprimtaria, sjellja ose statusi i tyre përbën rrezik real, të vazhdueshëm ose të përsëritur për sigurinë kombëtare, rendin publik, integritetin e industrisë së mbrojtjes ose përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare;

c) Dështojnë të ndërmarrin masa korrigjuese ose nuk bashkëpunojnë me Agjencinë për sqarimin apo eliminimin e rrethanave që kanë çuar në identifikimin e shkeljes.

2. Përfshirja në Regjistër bëhet kur plotësohen një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

a) Ekzistojnë të dhëna të verifikueshme dhe të dokumentuara, që provojnë përfshirjen e drejtpërdrejtë të subjektit në veprime ose mosveprime, që kompromotojnë interesat themelorë të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë;

b) Subjekti është përfshirë në listat e sanksioneve ndërkombëtare të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Bashkimi Evropian (BE), NATO-ja ose partnerë të tjerë strategjikë;

c) Subjekti është përfshirë në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit në Shqipëri, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) Ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë ndaj anëtarëve të Asamblesë së Aksionarëve për kryerjen e veprave penale, që lidhen me fushën e mbrojtjes, përfshirë krime kundër shtetit, rendit kushtetues, pavarësisë, krime kundër njerëzimit, vepra me qëllime terroriste apo që cenojnë marrëdhëniet ndërkombëtare;

d) Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim për përjashtimin e subjektit për arsye të interesit publik, sigurisë kombëtare ose për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

III. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Neni 5
Procedura

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes kryen verifikimet e nevojshme dhe njofton paraprakisht subjektin, vendas ose të huaj, për faktet e konstatuara dhe arsyet e mundshme të përjashtimit. Komunikimi bëhet me shkrim, në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj, të përcaktuar, rast pas rasti, dhe i jepet subjektit një afat jo më pak se 5 (pesë) ditë kalendarike për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim.

2. Pas administrimit të pretendimeve sipas pikës 1, të këtij neni, Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes ka një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike për të marrë vendimin për përfshirjen ose jo të subjektit në Regjistër.

3. Vendimi përfshin:

a) të dhënat identifikuese të subjektit;

b) përshkrimin e shkeljes;

c) bazën ligjore ku mbështetet masa;

ç) kohëzgjatjen e masës;

d) të drejtën e subjektit për ankimin administrativ.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet subjektit dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Subjekti i përjashtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rishqyrtim të masës nga data e hyrjes në fuqi të saj, duke bashkëngjitur prova për ndryshimin e rrethanave që kanë çuar në marrjen e vendimit.

7. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, me vendim të arsyetuar, vendos heqjen e subjektit nga Regjistri kur provohet se kushtet që çuan në përjashtim kanë ndryshuar ose janë zhdukur.

8. Vendimi për heqjen nga Regjistri i komunikohet subjektit dhe publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 6
Autoriteti përgjegjës për Regjistrin

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes është organi përgjegjës për administrimin e Regjistrit, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi dhe legjislacionin në fuqi.

2. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes mbikëqyr, siguron dhe është përgjegjëse për realizimin e të gjitha procedurave të regjistrimit dhe të përjashtimit të subjekteve, në përputhje me ligjin dhe parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së interesave kombëtare.

3. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes shqyrton kërkesat për heqjen nga Regjistri të subjekteve, në

përputhje me rastet dhe kushtet e përcaktuara nga ky vendim.

IV. REGJISTRI I SUBJEKTEVE TË PËRJASHTUARA

Neni 7
Përmbajtja dhe publikimi i Regjistrit

1. Regjistri përmban të dhëna për të gjitha subjektet e përjashtuara, të cilat kanë kryer veprimet për t'u konsideruar si të tilla, duke përfshirë informacion për:

a) numrin e identifikimit për personin tatimpagues (NIPT), emrin tregtar, të dhënat për pronësinë e subjektit dhe adresën e selisë;

b) të dhëna për sanksione ndërkombëtare të vendosura ndaj subjektit, nëse ka.

2. Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

3. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes kryen përditësimin e Regjistrit sa herë që ka ndryshime në statusin e subjektit.

V. PASOJAT DHE MJETET JURIDIKE

Neni 8
Efektet e përjashtimit

Me përfshirjen në Regjistër, subjektit të përjashtuar i ndalohet të ushtrojë çdo veprimtari, që lidhet me prodhimin, tregtimin, blerjen apo transferimin e produkteve dhe të teknologjive ushtarake, i anulohen ose i shfuqizohen, sipas Kodit të Procedurave Administrative, të gjitha licencat dhe autorizimet ekzistuese dhe i ndalohet aplikimi për licenca të reja.

Neni 9
E drejta e ankimit administrativ

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i vendimit të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, subjekti i përjashtuar ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ me shkrim pranë Komisionit të Ankimit Administrativ në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit, përveç rasteve kur Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është i domosdoshëm për interesin publik, sigurinë kombëtare, rendin publik ose mbrojtjen e shëndetit publik, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Komisioni i Ankimit Administrativ shqyrton ankimin dhe merr vendim të arsyetuar, brenda një afati jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e tij.

4. Vendimi i Komisionit të Ankimit Administrativ i komunikohet subjektit dhe Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe është i detyrueshëm për zbatim.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10
Institucionet që ngarkohen për zbatimin e vendimit

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 826, datë 30.12.2025

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "*ADRIATIC BAY INVESTMENT GROUP*" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE NR. 1/10, ME EMËRTIMIN "REPARTI USHTARAK 2001 – ISH-DEPO E MINAVE DURRËS", ZONA KADASTRALE 1574, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 52 010 m², ME VENDNDODHJE NË PORTO-ROMANO, DURRËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe shoqërisë "*Adriatic Bay Investment Group*" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 1/10, me emërtimin "Reparti ushtarak 2001 – ish-Depo e Minave Durrës", zona kadastrale 1574, me sipërfaqe të përgjithshme 52 010 (pesëdhjetë e dy mijë e dhjetë) m², me vendndodhje në Porto-Romano, Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, me afat 20 (njëzet) vjet, sipas kartelës së pasurisë, hartës kadastrale, genplanit dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ rep.
Nr. _____ kol.

KONTRATË QIRAJE

Në Tiranë, sot më _____, të muajit _____, të vitit _____, (_____), u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përfaqësuar me autorizim të titullarit të institucionit "qiradhënës", nr._____ nga z./znj. _____, me detyrë _____, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, i datëlindjes __.__._____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letërnjoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet **"QIRADHËNËSI"**

DHE

Shoqëria "*Adriatic Bay Investment Group*" sh.p.k., me seli qendrore në _____, me adresë: _____, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja, me NIPT: _____, përfaqësuar nga z./znj._____, i biri/bija i/e _____, i/e datëlindjes __.__._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi _____, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet "QIRAMARRËSI".

Institucioni "qiradhënës", me propozimin nr._____, datë ___.___._____, të _____, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në

zbatim të vendimit nr._____, datë __.__.____, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata", ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe shoqërisë "*Adriatic Bay Investment Group*", sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë nr. 1/10, zona kadastrale 1574, me sipërfaqe të përgjithshme 52 010 (pesëdhjetë e dy mijë e dhjetë) m^2, me emërtimin "Reparti ushtarak 2001 – ish-Depo e Minave Durrës", me vendndodhje në Porto-Romano, Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet e mëposhtme:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë nr. 1/10, me emërtimin "Reparti ushtarak 2001 – ish-Depo e Minave Durrës", në zonën kadastrale 1572, me sipërfaqe të përgjithshme 52 010 (pesëdhjetë e dy mijë e dhjetë) m^2, me vendndodhje në Porto-Romano, Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas dokumentacionit kadastral dhe genplanit, që i bashkëlidhen kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm e objektit të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate për zhvillimin e një qendre moderne magazinimi në fushën e agrobiznesit, duke përfshirë ndërtimin e kapanoneve metalike të përshtatura për përpunim, ruajtjen e mallrave bujqësore me destinacion eksportin dhe tregun vendas.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", nëpërmjet Komandës së Forcës Detare, si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira, i shoqëruar me foto, që është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Komandës së Forcës Detare, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 (tridhjetë) ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve, që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planin e biznesit paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

5.4 Qiramarrësi detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 Qiramarrësi detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij detyrimet, që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 Qiramarrësi detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin, objekt i kësaj kontrate, do të investojë për zhvillimin e një qendre moderne magazinimi në fushën e agrobiznesit, duke përfshirë ndërtimin e kapanoneve metalike të përshtatura për përpunimin, ruajtjen e mallrave bujqësore me destinacion eksportin dhe tregun vendas, në total **në vlerën 331 661 000 (treqind e tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë brenda 5 (pesë) vjetëve**. Sipas planit të biznesit bashkëlidhur, ky investim i qiramarrësit do të realizohet, si më poshtë vijon:

Ky projekt parashikohet të ndërtohet në dy faza:

Në fazën e parë: Kjo fazë parashikohet të zgjasë për një afat **2-vjeçar,** duke filluar momenti i marrjes së lejeve përkatëse nga institucionet shtetërore. Investimi në fazën e parë parashikohet të jetë **111 365 000** (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) **lekë për vit**. Gjatë kësaj faze do të fillojnë punimet për krijimin e infrastrukturës bazë, e cila përfshin: ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemet e drenazhit; rrjetin e telekomunikacionit dhe fibrat optike; shërbimet *wifi*; sistemin e fikseve të zjarrit; ndriçimin dhe sinjalistikat; sipërfaqet e gjelbra dhe zonat rekreative; sipërfaqet e parkimit, terminal kamionësh; sigurim kontrolli dhe mundësi aksesi hekurudhe.

- Në fazën e dytë, e cila do të fillojë pas mbarimit të fazës së parë, parashikohet të zgjasë rreth **3 (tre) vjet**. Fokusi i kësaj faze është projektimi dhe ndërtimi i godinave, i magazinave dhe i silosave. Investimi në fazën e dytë parashikohet të jetë **36 310 000** (tridhjetë e gjashtë milionë e treqind e dhjetë mijë) **lekë për vit.**

5.8. Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planin e biznesit të paraqitur, do të punësojë **20 (njëzet) punonjës** me kohë të plotë. Ky nivel punësimi do të arrihet pas 5 (pesë) vjetësh pasi të jenë marrë lejet përkatëse.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij. Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi.

5.9 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit në territorin, objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas pikave 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë te "Qiradhënësi", në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.14 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas pikave 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.2 "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet përpara se të firmoset kontrata.

6.3 Para nënshkrimit të kontratës, "qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës në formën garanci bankare/sigurimi, në vlerën 6,633,220 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet) lekë, sipas faturës së lëshuar nga "qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në pikën 5.7 të kësaj kontrate. Garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

6.4 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatëvonesa), "qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "qiradhënësit", sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse pas 6 muajve investimi vazhdon të mos realizohet, "qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshjeje kontraktore.

7.2 Në rastin kur "qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje ndërmjet palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur "qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

ç) kur "qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në pikën 5.7 të kësaj kontrate;

d) kur prona nevojitet për interes publik;

dh) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 (tridhjetë) ditë pas njoftimit me shkrim të "qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "qiramarrësi", sipas pikave 5.7 dhe 5.8, të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Komandës Mbështetëse në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuar, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "qiramarrësi" dhe "institucioni administrues dhe monitorues i kontratës së qirasë", Komanda e Forcës Detare në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, janë të detyruara që, çdo vit, të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose të gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë plani i biznesit, dokumentacioni kadastral dhe genplani përkatës.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe, në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura ndërmjet palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin që prona shtetërore e dhënë me qira, privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në 7 (shtatë) kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa unë, noter _____, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI	**QIRAMARRËSI**
Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	Shoqëria "*Adriatic Bay Investment Group*" sh.p.k.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
REPUBLIKA E SHQIPËRISË	R00000000SH	1/1

Numri i Pasurisë	1/10		
Kodi Unik	1574013193		
Zona Kadastrale	1574		
Lloji i Pasurisë	TRUALL		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 52010	Truall: 52010	Ndërtesë: 1948.6
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	DURRES, NB.FRUTORE, Rr.: -		

DREJTORI
Elvis Pengili

Jonida Mergeja — Digitally signed by Jonida Mergeja Date: 2025.06.13 12:02:01 +02'00'

Elvis Pengili — Digitally signed by Elvis Pengili Date: 2025.06.13 12:08:34 +02'00'

Data e lëshimit 13/06/2025

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2025/06/13 12:01:57 +02'00'
R00000000SH20250013120144 48L10

ASHK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1574013193
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1574 , Lloji i Pasurisë: TRUALL , Nr. i Pasurisë: 1/10 , Sipërfaqja Totale 52010 m2, (Nga të Cilat Truall 52010 m2; Ndërtesë 1948.6 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-87-238-D , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia NB.FRUTORE , Rruga - , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 515 , Dt. 18/07/2003), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË , Nr. Identifikimi/NIPT R00000000SH , Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia - , Rruga - , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 515 , Datë: 18/07/2003
Regjistruar: Nr. 03513 , Datë: 06/10/2022

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES SEKRETARIATI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
03513	23/05/2025	Përdorim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	220	21/03/2017	99 vite	REPARTI USHTARAK 2001	K51703517I

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: REGJISTROHET E DREJTA E PARABLERJES ME VENDIM GJYKATE SE APELIT NR. 10-2019-1214/435 DATA 25.06.2019 PER OBJEKTIN, DERI NE MARRJEN E FORMES SE PRERE TE VENDIMIT. PASURIA ESHTE NE PRONESI TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE ADMINISTRIM TE MINISTRISE SE MBROJTJES(KOMANDA E FORCAVE DETARE)

DREJTORI
Elvis Pengilli

Jonida Mergeja — Digitally signed by Jonida Mergeja, Date: 2025.06.13 12:02:36 +02'00'

Elvis Pengilli — Digitally signed by Elvis Pengilli, Date: 2025.06.13 12:08:23 +02'00'

Data e lëshimit 13/06/2025

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2025/06/13 12:02:17 +02'00'
R00000000SH2025061312021024ASH

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – MINISTRIA E MBROJTJES – SEKRETARIATI

2/2

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENTI I HARTES KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 1574 KODI UNIK: 1574013193

NUMRI I PASURISE: 1/10 INDEKSI HARTES: DR-

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH :2500

DREJTORI

Edisa Merkja — Digitally signed by: Edisa Merkja Date: 2025.07.29 10:35:34 +02'00'

Florian Xharja — Digitally signed by: Florian Xharja Date: 2025.07.29 11:20:13 +02'00'

SHPJEGUES:
- [ ] Objekt
- [ ] Parcele

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2025/07/29 10:35:23 +02'00'
K51705517I202507291035173401 4

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË)


GENPLAN
Prona nr.219 "Ish Depo Mina Detare", Porto Romano, Spitallë, Durrës
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (FD)
DATË 20.08.2025
QËLLIMI: Dhënie me qira
VENDNDODHJA
Bashkia DURRËS DVASHK DURRËS
Nr.Pasurisë 1/10
Z.K 1574
Indeksi i Hartës K-34-87-(238-B)
TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë TRUALL
Sip e pasurisë 52 010m²
Sip e gjurmës së ndërtimit 1948.6m²
Nr. kateve
Nord =4582318.05
East = 451504.86
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)
Nord =4582318.05
East = 451944.77
V
J
DETI ADRIATIK
Mur Antik
1KT
Tunel
Kullë Vrojt.
Lapidar
Vendr.
1/10
SHPJEGUESE:
Kufiri sipas gjendjes faktike
Sip. e përgj. = 52 010m²
Sip. nën objektin nr.1 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.2 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.3 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.4 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.5 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.6 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.7 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.8 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.9 = rrënojë
Sip. nën objektin nr.10= rrënojë
Sip. nën objektin nr.11= rrënojë
Sip.e përgj.nën objekte=1948.6m²(rrënojë)
Shënim:
- Objekte të rrënuara
Nord =4581966.98
East = 451504.86
SH 1: 2500
METRA
Nord =4581966.98
East = 451944.77
NR ORIENTIMI PERDORIMI TIPI I KUFIRIT KUFITARI ID/NIPT
1 Veri K51726024H
2 Lindje
3 Jug
4 Perëndim
REALIZOI PËR IGJIU
Ing. Eris Ndrukaj
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI
MsC.Ark Jurgen ÇOLAKU
TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor.
Shënime : Ky Genplan u hartua në zbatim të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm me nr.4722/2, datë 20.08.2025 bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, orto foto të vitit 2015-2016 e çertifikuar nga ASIGU.
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Komanda e Forcës Detare)
KOMANDANTI I FORCËS DETARE
Nënadmirall Adhanda GJASTRA
REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

VENDIM
Nr. 827, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.3 55, DATË 20.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRANSFERIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË ZONËN KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË, NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE DHE VËNIEN NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK "NGRITJA E PLANTACIONIT ME SHEGË, GOJI BERRY, KIVI, RRUSH, DARDHË ETJ., SI DHE ZHVILLIMIN E AGROTURIZMIT NË NJË SIPËRFAQE RRETH 131 HA, NË ZONËN E KARAVASTASË, BASHKIA DIVJAKË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 355, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e pronës shtetërore në zonën kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, njësia administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik "Ngritja e plantacionit me shegë, goji berry, kivi, rrush, dardhë etj., si dhe zhvillimin e agroturizmit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titull dhe në pikat 2, 4 dhe 5, pas fjalëve "... në një sipërfaqe rreth 131 ha ... " shtohen "... dhe të aktivitetit agrivoltaik në një sipërfaqe prej 68.6 ha ...".

b) Në pikën 3, pas fjalëve "... nr. 6/9, datë 24.6.2020 ..." shtohen "... dhe vendimin nr. 6 /16, datë 30.10.2023 ...".

c) Kudo në vendim, emërtimi "Ministria e Financave dhe Ekonomisë" zëvendësohet me "Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit".

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Bashkia Divjakë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe investitori strategjik "Agro Iliria Group" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 828, datë 30.12.2025

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Përfitojnë kompensim të të ardhurave mujore deri në 1 800 (një mijë e tetëqind) lekë në muaj personat me të ardhura deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj në datën 31.12.2025, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie të plotë të caktuar sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Personat që përfitojnë pension pleqërie të plotë urban, pension pleqërie si nënë me shumë fëmijë urban dhe pension të reduktuar të

pleqërisë, me datë lindjeje të së drejtës deri në datën 31.12.2014, të caktuara në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) Personat që përfitojnë pension pleqërie me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.1.2015 e në vijim, të caktuar në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që plotësojnë periudhën e domosdoshme të sigurimit të parashikuar në nenin 92, pension pleqërie si nënë me shumë fëmijë, të caktuar në bazë të pikës 2, të nenit 31, dhe pension pleqërie të reduktuar, të caktuar në bazë nenit 31/1, të këtij ligji.

ç) Personat që përfitojnë pension pleqërie të caktuar në bazë të ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë";

d) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit, të caktuar në bazë të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji".

2. Përfitojnë kompensim të të ardhurave mujore deri në 800 (tetëqind) lekë në muaj personat me të ardhura deri në 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë në muaj në datën 31.12.2025, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie të pjesshëm, të caktuar sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Personat që përfitojnë pension pleqërie të pjesshëm urban, me datë lindjeje të së drejtës deri në datën 31.12.2014, të caktuar në bazë të neneve 34 e 95, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) Personat që përfitojnë pension pleqërie, me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.1.2015 e në vijim, të caktuara në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që nuk plotësojnë periudhën e domosdoshme të sigurimit të parashikuar në nenin 92 të këtij ligji;

ç) Personat që përfitojnë pension social të caktuar, në bazë të nenit 5/1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Përfitojnë kompensim të të ardhurave mujore deri në 1 000 (një mijë) lekë në muaj personat me të ardhura deri në 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj në datën 31.12.2025, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie të caktuar në bazë të ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Personat që përfitojnë pension pleqërie rural, me datë lindjeje të së drejtës deri në datën 31.12.2014, të caktuar në bazë të neneve 31, 34, 93, 95 dhe të paragrafit të dytë, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

4. Përfitojnë kompensim të të ardhurave mujore deri në 600 (gjashtëqind) lekë në muaj personat me të ardhura deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj në datën 31.12.2025, që përfitojnë pension invaliditeti, të caktuar sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

5. Përfitojnë kompensim të të ardhurave mujore deri në 700 (shtatëqind) lekë në muaj personat me të ardhura deri në 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj në datën 31.12.2025, që përfitojnë pension familjar, të caktuar sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar.

6. Masa individuale e kompensimeve të parashikuara në këtë vendim do të përfitohet deri

në plotësimin e vlerës së të ardhurave të parashikuar në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi.

Për të gjitha rastet që kompensimi i parashikuar sjell si pasojë tejkalimin e vlerës së të ardhurave sipas pikave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi, masa individuale e kompensimit do të llogaritet si diferencë e të ardhurave të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi, me shumën e të ardhurave mujore të përfituesve, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

7. Në kuptim të këtij vendimi, të ardhurat mujore të përfituesve të pensioneve, sipas pikave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi, përfshijnë:

a) masën e pensionit;

b) shtesën mbi pensionin e posaçëm shtetëror, të parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesën mbi pensionin e pleqërisë të caktuar sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

ç) trajtimet e veçanta financiare, sipas neneve 5/1/a, 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

d) përfitimet sipas dekretit nr. 758, datë 1.2.1994, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", të miratuar me ligjin nr. 7799, datë 24.2.1994, të Kuvendit Popullor, dhe ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë", ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension", të ndryshuar, ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundrues, të nëndetëseve dhe palombarëve të Forcave Detare, në pension", ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", ligjit nr. 129/2021, "Për statusin 'Fëmijë në përkujdesje të Republikës'";

dh) kompensimet sipas vendimit nr. 763, datë 27.11.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", vendimit nr. 401, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve", vendimit nr. 17, datë 20.1.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit", vendimit nr. 415, datë 27.4.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për rritjen e pensioneve", vendimit nr. 474, datë 30.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për rritjen e pensioneve".

8. Kompensimi shtesë për të ardhurat mujore, sipas këtij vendimi, u jepet edhe personave që do t'u caktohet pension nga data 1.1.2026 e në vazhdim, të cilët kanë datë lindjeje të së drejtës për pension deri në datën 31.12.2025, përfshirë edhe këtë datë, me kusht që masa e pensionit dhe përfitimet e përmendura në shkronjat "b", "c", " ç", "d" dhe "dh", të pikës 7, të këtij vendimi, në datën 31.12.2025 të mos kalojnë të ardhurat e parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi.

9. Kompensimi shtesë për të ardhurat mujore, sipas këtij vendimi, u jepet edhe personave që do t'u caktohet pension nga data 1.1.2026 e në vazhdim, me kusht që data e lindjes së të drejtës për pension të jetë deri në datën 31.12.2026, përfshirë edhe këtë datë, me kusht që masa e pensionit dhe përfitimet e përmendura në shkronjat "b", "c", " ç" "d" dhe "dh", të pikës 7, të këtij vendimi, në datën e lindjes së të drejtës për pension të mos kalojnë të ardhurat e parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi. Personave, që do u caktohet pension me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.1.2027 e në

vazhdim, nuk janë subjekte përfituese sipas këtij vendimi.

10. Kompensimet e përfituara sipas këtij vendimi nuk do të jenë objekt ndryshimi, në rastet e indeksimit të pensioneve me vendime të Këshillit të Ministrave.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi llogariten në shumën 9 800 960 000 (nëntë miliardë e tetëqind milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të cilat ndahen:

a) 9 728 460 000 (nëntë miliardë e shtatëqind e njëzet e tetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mbulimin e pagesave të kompensimit të të ardhurave mujore të pensionistëve;

b) 72 500 000 (shtatëdhjetë e dy milionë e pesëqind mijë) lekë shpenzime administrative për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 9 800 960 000 (nëntë miliardë e tetëqind milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i shtetit, i planifikuar në buxhetin për sigurimet shoqërore, për vitin 2026.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 829, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 789, DATË 15.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit , Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

I. Në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 4 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas fjalëve "Masa e shpërblimit financiar ..." shtohen "... për sportet olimpike ,...";

b) Pas fjalëve "... ndërkombëtare/kombëtare e atij sporti ..." shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Për sportet joolimpike, shpërblimi financiar është në masën 40 (dyzet) % të vlerave të përcaktuara në tabelën I dhe në masën 100% të vlerave të përcaktuara në tabelën II.".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

"4/1. Sportisti shpërblehet financiarisht vetëm për një rezultat sportiv të arritur në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, Kampionat Botëror, Evropian, Ballkanik, gjatë vitit kalendarik, në një disiplinë, sipas tabelës nr. I. Në sportin e peshëngritjes, sportisti i klasifikuar në dygarësh shpërblehet vetëm për rezultatin përfundimtar, në masën 100%.".

3. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Kategoria "të rinj" përcaktohet nga niveli "*Junior Championship*" i kampionatit ndërkombëtar

ose në moshat U-16, U-17, U-18, U-19 vetëm në rastet kur mungon kategoria "*Junior Championship*" në federatat përkatëse ndërkombëtare.".

4. Në pikën 9, togfjalëshi "... 2 500 (dy mijë e pesëqind) ..." zëvendësohet me "... 3 500 (tre mijë e pesëqind) ...".

5. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, që ka arritur rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës nr. I, federata shqiptare sportive përkatëse aplikon në portalin unik qeveritar "*e-Albania*". Në aplikim përcaktohet rezultati përfundimtar në veprimtarinë ndërkombëtare, në të cilën sportisti ka marrë pjesë, si dhe deklarimi i federatës që sportisti nuk ka rekorde pozitive të *doping*-ut, të konfirmuar nga Organizata Kombëtare Antidoping. Ministria përgjegjëse për sportin verifikon përmbushjen e kritereve pas marrjes së kërkesës dhe, në rast të të metave në aplikim, aplikuesi ka të drejtën për plotësimin e tyre brenda afatit shtatëditor.".

6. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

"13/1. Federata duhet të kryejë pagesën e shpërblimit të sportistit dhe trajnerit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga disbursimi i fondeve nga ministria përgjegjëse për sportin.".

7. Pika 17/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar *"e-Albania",* zbatohet pasi ministria përgjegjëse për sportin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare realizimin e shërbimit elektronik. Deri në këtë njoftim, aplikimet do të dorëzohen në formë shkresore pranë ministrisë përgjegjëse për sportin.".

II. Tabela nr. 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr. 1:

Veprimtaria	Rezultati	Masa e shpërblimit
	Rekord olimpik	15 000 000 lekë
	Rekord botëror	15 000 000 lekë
	Rekord evropian	6 000 000 lekë
	Rekord mesdhetar	3 000 000 lekë
	Rekord ballkanik	1 500 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i parë	15 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	10 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	7 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	4 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	2 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	1 000 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	800 000 lekë
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	500 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	4 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i katërt	2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i pestë	1 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	800 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i shtatë	600 000 lekë

Kampionat botëror	Vendi i tetë	400 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i parë	4 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i dytë	2 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i tretë	1 000 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i katërt	800 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i pestë	600 000 lekë
Kampionat evropian	Vendi i gjashtë	400 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i parë	2 000 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i dytë	1 000 000 lekë
Lojëra Mesdhetare	Vendi i tretë	800 000 lekë
Kampionati Ballkanik	Vendi i parë	1 000 000 lekë

VENDIM
Nr. 830, datë 30.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KRITEREVE PËR FINANCIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR ME IMPAKT SOCIAL, KULTUROR, EKONOMIK DHE TURISTIK NË VEND, NË RASTET KUR ZHVILLOHEN NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton procedurat dhe kriteret për financimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar me impakt social, kulturor, ekonomik dhe turistik në vend, në rastet kur zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

II. KRITERET PËR FINANCIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR

Subjekti aplikues, për financimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar, duhet të plotësojë këto kritere:

a) Regjistrimi ligjor i subjektit të jetë, sipas legjislacionit në fuqi, vendas ose të huaj, dhe ushtrimi i veprimtarisë të jetë në përputhje me objektin e tij;

b) Të jetë dhënë njohja zyrtare e aktivitetit ndërkombëtar nga federata ndërkombëtare përkatëse, e dokumentuar me vërtetim zyrtar dhe e vlefshme për periudhën e zhvillimit të aktivitetit ndërkombëtar;

c) Të ketë marrë dakordësinë e federatës ndërkombëtare ose të ketë marrëveshje partneriteti ndërkombëtare;

ç) Të ketë eksperienca të ngjashme në organizimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar;

d) Të ketë kapacitetet organizative, administrative dhe menaxheriale, përfshirë strukturën organizative, stafin dhe përvojën në organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare të ngjashme;

dh) Aktiviteti ndërkombëtar të ketë ndikim ekonomik, turistik dhe mediatik, përfshirë numrin e pjesëmarrësve ndërkombëtarë, delegacioneve dhe ekspozimin ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.

III. PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR FINANCIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR

1. Subjektet aplikuese përgjatë të gjithë vitit buxhetor paraqesin kërkesë për financim pranë ministrisë përgjegjëse për sportin, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimmarrjen e brendshme të subjektit aplikues, të miratuar nga organi drejtues kompetent, për realizimin e aktivitetit ndërkombëtar sportiv;

b) Programin e detajuar të aktivitetit ndërkombëtar, përfshirë kohëzgjatjen, strukturën e

garave, disiplinat sportive dhe kalendarin e zhvillimit;

c) Vërtetimin nga federata ndërkombëtare për njohjen e aktivitetit ndërkombëtar;

ç) Planin teknik të detajuar të organizimit të aktivitetit ndërkombëtar;

d) Planin financiar të detajuar.

2. Për vlerësimin e aplikimeve të paraqitura pranë ministrisë përgjegjëse për sportin ngrihet një komision *ad hoc* vlerësimi, i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, i cili ngrihet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së aplikimit. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, komisioni brenda 7 (shtatë) ditëve, nëse konstaton parregullsi, njofton aplikuesit, duke iu caktuar afatin 5 (pesë)-ditor për plotësimin e tyre.

3. Komisioni i Vlerësimit, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga ngritja e tij shqyrton dokumentacionin e paraqitur, zhvillon negociatat për kushtet e kontratës, propozon miratimin ose mosmiratimin e aktivitetit dhe i paraqet ministrit përgjegjës për sportin raportin e detajuar për miratimin ose jo të aktivitetit. Subjekti aplikues njoftohet për vendimin brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e miratimit. Aplikuesit mund të ankimojnë vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit brenda 5 (pesë) ditëve te ministri përgjegjës për sportin.

4. Pas lidhjes së kontratës, çdo pagesë e ministrisë përgjegjëse për sportin për subjektet përfituese bëhet pas paraqitjes së kërkesës së këtij të fundit dhe në përputhje me parashikimet e kontratës, përfshirë edhe pagesën e tarifës së pjesëmarrjes (*fee*), në rast parashikimi në kontratë.

5. Ministria përgjegjëse për sportin autorizon kryerjen e pagesës pas dorëzimit nga subjekti përfitues të dokumentacionit të mëposhtëm:

a) Kërkesës për pagesë;

b) Faturës së lëshuar nga subjekti kontraktor, sipas rregullave në fuqi në vendin e regjistrimit si person juridik;

c) Në rast se në kontratë do të parashikohet tarifë pjesëmarrjeje (*fee*), ministria përgjegjëse për sportin kryen pagesën bazuar në faturën e lëshuar, sipas përcaktimeve në kontratë për vlerën e tarifës së pjesëmarrjes (*fee*).

6. Për monitorimin e aktivitetit sportiv me karakter ndërkombëtar ngrihet grupi i monitorimit, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët caktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

7. Përjashtimisht, aktivitetet sportive me karakter ndërkombëtar, për të cilat fondet janë parashikuar në ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, financohen në përputhje me parashikimet e këtij vendimi. Në këtë rast, aplikuesit shoqërojnë kërkesën për aplikim me dokumentacionin e parashikuar në kreun II, të këtij vendimi, shoqëruar me dokumentacionin financiar justifikues. Ministri përgjegjës për sportin urdhëron kryerjen e pagesës nëpërmjet thesarit në bankën e nivelit të dytë ose Bankën e Shqipërisë, përfshirë transfertat e huaja, të deklaruar nga përfituesi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 834, datë 30.12.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 15, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2025", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 2
BUXHETI PËR SHËRBIMIN SPITALOR

(në mijë lekë)

EMERTIMI	ARTIKUJT					
	art.600	art.601	art.602	art.602 PPP laboratorë	604	total
QSR BERAT	536,391	87,900	234,080	64,000		922,371
BULQIZE	114,553	18,867	30,000			163,420
DELVINE	54,360	9,020	8,540			71,920
DEVOLL	69,920	11,500	13,460			94,880
DIBER	392,080	63,900	135,000	33,000		623,980
ELBASAN	694,600	113,550	340,000	110,000		1,258,150
FIER	560,500	91,950	251,154	115,000		1,018,604
GRAMSH	174,270	28,650	44,000			246,920
GJIROKASTER	328,100	52,950	120,000	36,000		537,050
HAS	65,510	10,870	18,832			95,212
KOLONJE	114,604	18,634	20,000			153,238
KORCE	642,000	105,700	313,280	85,000		1,145,980
KRUJE	178,420	29,420	32,000			239,840
KUKES	374,600	61,900	141,580	37,000		615,080
KURBIN	132,250	21,980	41,290			195,520
LEZHE	402,900	65,140	190,000	65,000		723,040
LIBRAZHD	215,590	35,090	59,000			309,680
LUSHNJE	328,250	53,880	107,000	48,000		537,130
MALESI E MADHE	37,300	6,120	6,600			50,020
MALLAKASTER	61,350	10,050	13,000			84,400
MAT	190,210	31,074	45,190			266,474
MIRDITE	145,050	23,780	30,000			198,830
PEQIN	52,100	8,640	7,500			68,240
PERMET	112,750	18,350	35,000			166,100
POGRADEC	250,450	41,000	92,000			383,450
PUKE	141,865	22,900	40,000			204,765
SARANDE	236,650	38,700	120,000	35,000		430,350
SKRAPAR	111,500	18,410	18,000			147,910
SHKODER	831,087	136,280	396,650	70,000		1,434,017
TEPELENE	114,100	18,110	16,000			148,210
QSU "NENE TEREZA"	3,771,200	612,190	6,686,845	850,000		11,920,235
SUOGJ "MBRETERESHA GERALDINE"	441,850	71,820	300,000	33,000		846,670
SUOGJ "KOCO GLIOZHENI"	350,410	56,290	300,000	34,000		740,700
QSR "SHEFQET NDROQI"	756,810	122,772	968,700	63,000		1,911,282
TRAUMA	190,300	30,300	370,000	60,000		650,600
TROPOJE	146,760	24,270	40,000			211,030
VLORE	594,450	96,780	376,750	78,500		1,146,480
"MEMORIAL" FIER					794,947	794,947
DURRËS				83,500	1,480,000	1,563,500
Paketat e shërbimeve jopublik					1,641,765	1,641,765
